

Për: Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12
Prishtinë, 10000, Kosovë

Nga: FUENTE DYNAMICS
Rr. Lordi Bajron, kompleksi Prishtina Stars nr. 27, Prishtinë

Datë: 8 dhjetor 2021

Komentet në Raportin Konsultativ

Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative të Furnizuesit me Shërbim Universal/ Rishikimi i Vlerave Hyrëse (2022-2024)

Të nderuar,

Në tabelën e mëposhtme, brenda afatit të publikuar, mund të gjeni komentet tona në gjashtë pozicione të Raportit Konsultativ : Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative të Furnizuesit me Shërbim Universal/ Rishikimi i Vlerave Hyrëse (2022-2024). Në narracion të saj, komentet tona janë të vendosura në raport me paragrafët relevant në Raport, të cituara dhe krahas numrit të faqes në raport.

Me respekt,

FUENTE Dynamics



NR. I FAQES	PARAGRAFI I REFERUAR	KOMENTET
7.	<p>Duke marr në konsideratë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • KESCO-FSHU nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të volumeve të energjisë, për më tepër energjia nga KEK ofrohet me prioritet për FSHU; • Blerjet që bëhen nga tregtarët barten në kostot e FSHU-së; • Kostot e plota të FSHU-së njihen dhe përshtaten gjatë shqyrtimeve tarifore; • Analizimin e të dhënave historike, përvojave rregullatore, kushteve dhe rrethanave të operimit të Furnizuesit me Shërbim Universal 	<p>ZRRE gjatë shqyrtimit dhe propozimit për marzhën me pakicë, si njërin nga kriteret e shqyrtimit merr parasysh blerjet që bëhen nga tregtarët dhe kostot e të cilave barten tek FSHU-së. Megjithatë, raportit i mungon një analizë e asaj se cilat blerje të cilat bëhen nga tregtarët duhet të merren në konsideratë për nevojat e FSHU. Për qëllime të kësaj analize, e konsiderojmë të rëndësishme që të bëhet identifikimi i volumit të blerjeve të nevojshme të energjisë nga tregtarët për nevoja të FSHU në shifra të sakta. Po aq e rëndësishme është që këto blerje të ndahen nga blerjet e nevojshme për nevojat e mbulimit të humbjeve në rrjetin e distribuimit. Ne konsiderojmë se për aq kohë sa KES-CO vazhdon të organizojë blerjet edhe për KEDS, do të jetë pothuajse e pamundur ndarja e këtyre kostove për këto dy qëllime. Përveç kësaj, ndarja bëhet edhe më e vështirë kur sasia e nevojshme për konsumatorët fundor sigurohet nga KEK përmes bulk supply agreement – marrëveshje e cila sipas informatave tona ende është në fuqi. Bazuar në këtë narrativë, e konsiderojmë të parakohshme që ZRRE të merr në konsideratë “blerjet që bëhen nga tregtarët dhe kostot e të cilave barten tek FSHU-së” për të përcaktuar marzhën, respektivisht që kjo rrethanë të ndikojë në përcaktimin e marzhës.</p>
10.	<p>Një llogaritje e saktë e ndikimit të derregullimit në normën e inkasimit të FSHU-së do të kërkonte, ndër të tjera, një identifikim të numrit të konsumatorëve të kyçur në rrjetet 35 kV dhe 10 kV që kualifikohen për kriteret e referuara në nenin 37.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike. Në mungesë të të dhënave të Energjinë Elektrike. Në mungesë të të dhënave të tilla, për qëllim të këtij shqyrtimi, ZRRE ka supozuar se asnjë nga konsumatorët në nivelet 35 kV dhe 10 kV nuk i plotëson këto kriteret dhe - prandaj - të gjithë janë subjekt i derregullimit. Llogaritja e normave të inkasimit që rezultojnë dhe ndryshimi në</p>	<p>Numri i konsumatorëve të kyçur në rrjetet 35 kV dhe 10 kV që kualifikohen për kriteret e referuara në nenin 37.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike e konsiderojmë se duhet të jetë databazë e qasshme, transparente dhe publike. Nga diskutimet gjatë vitit 2021 rikujtojmë se ZRRE ishte zotuar se këto të dhëna do t'i publikonte për lehtësinë e furnizuesve dhe konsumatorëve të interesuar. Pavarësisht mënyrës se si ZRRE mund të ketë zgjedhur që të sigurojë këto të dhëna, në rrethana normale do të duhej të ishte detyrim i KESCO që të ofrojë qasje në to. Përveç nevojës permanente që furnizuesit dhe konsumatorët të kenë qasje në këto të dhëna, është informata shumë e rëndësishme në llogaritjen e efektit të derregullimit në normën e inkasimit – duke mos</p>

	<p>pikë përqindje nga nivelet e vitit 2019 janë paraqitur në Tabelën 4, më poshtë.</p>	<p>qenë të detyruar që të bëhen shqyrtime dhe propozime bazuar në hipoteza.</p>
<p>12.</p>	<p>Meqenëse nuk pritet asnjë ndryshim i dukshëm në aftësinë e KESCO-së për të menaxhuar jobalancet para vitit 2023, asnjë ndryshim në faktorin ndarës të jobalancave nuk justifikohet. Një reduktim pas vitit 2023, duke e ekspozuar KESCO-në ndaj një rreziku më të madh të kostove të jobalancit, mund të justifikohet nëse ALPEX është plotësisht operacional.</p>	<p>Nuk e konsiderojmë se një ALPEX plotësisht operacional do t'a ekspozojë KESCO-në ndaj një rreziku më të madh të jobalancave. Përkundrazi, ne e shohim se me operacionalizimin e ALPEX-it do të rritet mundësia e KESCO-së për të menaxhuar më mirë jobalancet, duke qenë se do të ketë qasje në treg vendas pa shtuar kostot shtesë për kapacitet transmetuese. Në anën tjetër, aftësia parashikuese për konsum nuk ndikohet nga operacionalizimi i ALPEX-it.</p> <p>Në ndërkohë, tregu i balancimit veçse mund të quhet i bashkuar me Shqipërinë për aq sa KOSTT është në zonën rregulluese të OST në fund të ditës. Pra, çmimi i jobalancave nuk ndryshon me operacionalizimin e ALPEX-it për aq kohë sa KOSTT nuk ndryshon metodologjinë për llogaritjen e tij – ku në vend të çmimit bazë HUPX të konsiderojë çmimet në tregun e ditës në avans në ALPEX.</p>
<p>12.</p>	<p>Sidoqoftë, mund të merr kohë derisa ALPEX të bëhet funksional dhe aktualisht fillimi i tij mbetet i panjohur, po-ashu edhe shkalla e tregut dhe likuiditetit janë të panjohura tani. Duke pasur parasysh këtë, është joreale të presësh që KESCO ose pjesëmarrës të tjerë të tregut të jenë në gjendje të mbështeten tek ALPEX për të menaxhuar jobalancet me kosto të ulët për periudhë deri në vitin 2023.</p>	<p>Sërish, e konsiderojmë se ky përfundim është i mbështetur mbi hipotezën se ALPEX do të jetë platformë për të menaxhuar jobalancet me kosto më të ultë. Është e paqartë se pse hipoteza mbështet në kosto më të ultë, kjo në veçanti për shkak se po diskutohet për mungesë të energjisë elektrike në të dyja anët. Përveç kësaj, ZRRE duhet të ketë parasysh se kostot e CER-et apo "green certificate" që i duhen KEK-ut në momentin e tregimit në bursë është e pamundur të shmangen .</p>
<p>12.</p>	<p>Sidoqoftë, tregu i energjisë elektrike në Kosovë është i vogël dhe jo-likuid. Vetëm një numër i vogël i gjeneratorëve marrin pjesë, të cilët janë kryesisht jo fleksibil dhe nuk mund të përshtatin lehtë prodhimin, dhe kontratat e importit vazhdojnë të përballen me kufizime. Duke pasur parasysh këtë,</p>	<p>Këtë masë e konsiderojmë si masë diskriminuese ndaj operatorëve të tjerë për arsye të vijim. Përmes saj, ZRRE motivon KESCO për të rregulluar pozicionin e jobalancave, përderisa të gjithë operatorëve të tjerë nuk ju lejojnë fare jobalancet nga KOSTT. Kjo masë diskriminon operatorët e tjerë të cilët kanë të njejtat vështirësi nga KESCO. Në veçanti, e shohim të rrugës që kjo masë të shqyrtohet në raport me</p>

	<p>faktori ndarës i jobalanceve aktualisht është përcaktuar në 100%, që do të thotë që të gjitha kostot e balancimit kalojnë te konsumatorët (qofshin ato pozitive apo negative), duke ditur që KESCO ka pak mundësi për të rregulluar blerjet e energjisë para kohe për të përmbushur kërkesën.</p>	<p>fillimin e liberalizimit të tregut. Prandaj shtrohet pyetja, si do të veprojë një furnizues i ndryshëm nga KESCO – të jetë i detyruar të balancojë veten, të paguajë, apo t’ua ngarkojë edhe ai operator të gjitha kostot e balancimit konsumatorëve.</p> <p>Përveç këtyre, konsiderojme se ka bazë diskriminuese duke qenë se vet KESCO do të dal në treg të lirë. Nëse faktori ndarës i jobalanceve është 100%, atëherë shtrohet pyetja se si do të identifikohen jobalancet e shkaktuara nga konsumatorët tarifor në raport me ato të shkaktuara nga konsumatorët jotarifor duke qenë se KESCO ka vetëm një grup balancimi.</p>
<p>13.</p>	<p>Bazuar në shpjegimin që ka të bëjë me rrethanat aktuale dhe pritjet për integrim në tregun e përbashkët ALPEX, ZRRE pajtohet me propozimin e KESCO që i njëjti faktor ndarës 100% duhet të mbahet për periudhën 2022 deri në 2024 duke pasur parasysh që këto rrethana do të vazhdojnë të mbizotërojnë në tregun vendor të energjisë.</p>	<p>Ne konsiderojmë se jobalancet nuk janë të varura nga ALPEX, dhe nuk ka ndërlidhje në mes të tregut të ditës në avans apo atij intra day dhe jobalancës që shkaktohet në treg. E njejtja mundësi për të bërë rregullimet në intra day ekziston edhe sot.</p>